

V E N D I M
Nr.652, datë 5.12.2000

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.224, DATË 15.5.1995, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E KËSHILLIT KONSULTATIV TË
AVIACIONIT CIVIL”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8, të ligjit nr.7877, datë 31.11.1994, “Për aviacionin civil shqiptar”, me propozimin e ministrit të Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.224, datë 15.5.1995, të Këshillit të Ministrave bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1, paragrafi i dytë, ndryshohet si vijon:

“Këshilli Konsultativ i Aviacionit Civil ka përbërjen e mëposhtme:

- Ministri i Transportit kryetar
- Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit anëtar
- Ministri i Mbrojtjes anëtar
- Ministri i Rendit Publik anëtar
- Ministri i Financave anëtar
- Ministri i Drejtësisë anëtar
- Ministri i Pushtetit Lokal anëtar
- Kryetari i Komitetit të Turizmit anëtar
- Drejtori i Përgjithshëm i aviacionit civil sekretar.”.

2. Pas pikës 1, shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“Kur ministri, për arsye objektive, nuk mund të marrë pjesë në mbledhje, ai delegon zëvendësministrin.

Në raste të veçanta, me miratimin e kryetarit, në mbledhjen e Këshillit Konsultativ marrin pjesë specialistë të ndryshëm, sipas problemeve që do të trajtohen.”

3. Në pikën 6 fjalët “industrisë” dhe “dhe tregtisë”, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta